

# Elementet e një Debatit të suksesshëm

## Arti i fjalës

E folura me bindje, qartësisht dhe artikulimi janë elemente për përcjelljen e argumenteve dhe ideve. Ato krijojnë një sens saktësie si rrjedhim i sigurisë në të folur.

## Argumentet

Strukturimi i saktë i argumentete në strukturë pikëzimi si më poshtë:

1. Përdorimi i pikave për çdo argument, lehtëson ndjekjen e një debati dhe bëhet më angazhues nga të dyja palët;
2. Përdorimi i pikave gjithashtu në përmbledhje të një debati, konkretisht për folësit përmbysës, vlen për të shtruar argumentet e parathëna të cilat mund të shërbejnë për të arsyetuar pse argumentet e një skuadre vlejné dhe qëndrojnë mbi tjetrën.

## Fjalimi

Përmbajtja e një fjalimi në debat duhet të përmbledhi disa elemente kryesore si më poshtë:

1. Argumente të cilat kanë një rrjedhe logjike dhe i përmbahen saktë një teme të debatit;
2. Përdorimi logjik i statistikave në mbështetje të argumentit;
3. Përdorimi i kundër argumentit si mjet efikas për të hedhur poshtë argumentet e skuadrës kundëstare por edhe sjellja e alternativave;
4. Sjellja e një alternative është metodologji kyçe për të fituar një debat dhe jo vetëm hedhja poshtë e një argumenti.

## Etika në Debat

Respektimi i kundërshtarëve është një element shumë i rëndësishëm, respektimi i kohës dhe falenderimi për sjelljen e argumenteve tregon maturi se ndonëse mund të jenë kundërshtar janë bashkë debatues dhe si të tillë duhen respektuar. Etika në debat duhet ndjekur gjithnjë. Nuk duhet të ndërpresim fjalën apo argumentin kolegut kundësthtar.

## Përdorimi i pyetjeve

Përdorimi i pyetjeve është një strategji e zhvilluar dhe funksionale me shembuj si më poshtë:

1. Përdorimi i pyetjeve si mjet i shpërqëndrimit ose drejtimit në një rrjedhë tjetër logjike, mund të vlejë për ta drejtuar debatuesin kundërshtar në një argument që mund të jetë i fortë për antarin e skuadrës e cila e shtron pyetjen;
2. Pyetjet retorike përforcojnë argumentin më tepër;
3. Pyetjet sygjeruese mund të drejtojnë kah një argumenti të fortë që i vlen skuadrës që e parashtron.

